



BURSA STUDIUMI PËR MASTER NË BARCELONË - SPANJË

Fondacioni "La Caixa" dhe Graduate School of Economics - Barcelona ofrojnë 14 bursa të plota studimi për master në shkencat ekonomike, për studentë të cilët kanë dëshmuar përgatitje të lartë akademike përgjatë studimeve të tyre të rregullta.

Programet e studimit janë:

- MA në Ekonomiks dhe Financa
- MA në Konkurrencë dhe Rregullim Tregu
- MA në Ekonomiksin e Shkencës dhe Inovacionit
- MA në Politikën Makroekonomike dhe Tregjet Financiare
- MA në Tregti Ndërkombëtare, Financa dhe Zhvillim

Bursat janë të dedikuara për studentë që vijnë nga vendet në zhvillim. Studentët pas mbarimit të studimeve master në Barcelona GSE, detyrimisht duhet të kthehen në vendin e tyre, në mënyrë që njohuritë e përfituara t'i aplikojnë në vendet e tyre.

Bursat mbulojnë:

- pagesën e studimeve për master (participimin)
- sigurimin shëndetësor
- shpenzimet e udhëtimit
- mbulim financiar të shpenzimeve mujore përgjatë studimit në Barcelona GSE

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- certifikatë notash
- letër motivimi
- autobiografi e shkurtër (CV)
- dëshmi për njohje të gjuhës angleze

Po ashtu dy letra rekomandimi duhet të dërgohen në adresë: references@barcelonagse.eu

Aplikimi duhet të bëhet në formë elektronike, nëpërmjet: <http://apply.barcelonagse.eu/login.php>

AFATI I FUNDIT PËR APLIKIM ËSHTË DATA: 01 GUSHT 2010

Për informacione më të detajuara vizitoni <http://www.barcelonagse.eu> ose drejtohuni në Qendrën për Shërbime Studentore dhe Karrierë - QESHK.